

VENDIM
Nr.22, datë 12.12.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË PËRJASHTIMIT TË OPERACIONEVE HIDROKARBURE
NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TVSH

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z.Genc Ruli - kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi - anëtare
Znj. Mimoza Vokshi - anëtare
Z.Viktor Gumi - anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.12.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese të përjashtimit të operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Drejtoria e Politikave Industriale/METE dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën nr.225/4, datë 7.3.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AL/002/2005.

BAZA LIGJORE: Si bazë për përjashtimin e operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja është dekreti nr.782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)” dhe dekreti nr.1510, datë 28.6.1996 “Për një ndryshim në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, ndryshuar me ligjin nr.8070, datë 15.2.1996”.

OBJEKTIVI/AT: Skema synon të lehtësojë zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve që operojnë në fushën e hidrokarbureve, nëpërmjet përjashtimit të operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja, duke mundësuar njëkohësisht zhvillimin social-ekonomik të zonave në të cilat është i autorizuar ushtrimi i kësaj veprimtarie.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema mbulon të gjitha ndërmarrjet, të cilat ushtojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në fushën e operacioneve hidrokarbure.

2. Skema synon të ndihmojë ndërmarrjet që nënshkruajnë “Marrëveshje hidrokarburesh” dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga detyrimet doganore për pajisjet, makineritë, materialet, si dhe një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, përjashtim i cili nuk jepet për sektorët e tjerë të ekonomisë.

3. Në sektorin e hidrokarbureve funksionon një sistem i veçantë fiskal. Ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë në këtë fushë, i nënshtrohen një tatimi mbi fitimin, në masën 50%.

4. Deri më sot, të gjitha ndërmarrjet që kanë ushtuar veprimtarinë e tyre në bazë të kësaj skeme, nuk kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit mbi fitimin, sepse nga aktiviteti i tyre nuk ka rezultuar zbulimi i naftës dhe më pas shfrytëzimi i rezervave të reja të naftës dhe gazit dhe rrjedhimisht nuk ka pasur shitje të produktit. Përjashtimi ekziston për ndërmarrjen e Bankers Petroleum Albania, e cila deri më sot nuk ka arritur të mbulojë me të ardhurat e saj kostot totale të aktivitetit të saj në përputhje me programin e zhvillimit. Mbështetur në këtë program, në vitin 2009, kjo ndërmarrje parashikon të realizojë një rezultat financiar pozitiv, duke iu nënshtruar detyrimit për pagesën e tatimit fitimit.

5. Aktualisht disa prej ndërmarrjeve janë duke kryer një veprimtari fitimprurëse nga nxjerrja, shitja dhe eksportimi i naftës dhe nënprodukteve të saj. Buxheti i Shtetit nuk ka njohur, deri në këtë periudhë, të ardhura nga aplikimi i faktorit R dhe nga tatimi mbi fitimin në kontratat me ndarje prodhimi për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve të lidhura mes METE dhe personave.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13, shkronja “c” dhe nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën Shtetërore”,

PROPOZON:

1. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të raportojë brenda datës 31 mars të çdo viti, të

dhënat për rezultatet e zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure në vitin paraardhës financiar.

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, të ruajë të dhënat për skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale deri pas 10 vjetësh nga data e përfundimit të marrëveshjes së fundit hidrokarbure në kuadër të zbatimit të këtij ligji.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli